

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: PUNË DINJITOZE DHE RRRITJE EKONOMIKE

Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

Target: Objektivi 8.1

8.1 Të mbështetet rritja ekonomike për frymë në përputhje me kushtet kombëtare dhe, në veçanti, për vendet më pak të zhvilluara kjo rritje të jetë të paktën 7 % e prodhimit të brendshëm bruto në vit.

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Nuk ka rezultat

Ligjet

Nenet

Neni 5

LIGJI NR. 06/L-016
PËR SHOQËRITË
TREGTARE
LIGJI NR. 06/L-016
PËR SHOQËRITË
TREGTARE

. Neni 5 Llojet e Shoqërive Tregtare në Kosovë 1. Një Shoqëri Tregtare mund të themelohet në Kosovë si Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare. 2. Përveç formave themelore të organizimit të Shoqërive Tregtare të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve regjistrohen edhe Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë, Zyra e Përfaqësisë së Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë, ndërmarrjet publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. 3. Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Forma e organizimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera rregullohen në ligjin përcaktës më të cilin krijohet Shoqëria Tregtare ose subjekti përkatës. Dispozitat e ligji të veçantë që rregullojnë këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera, duke përfshirë dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji.

Ligjet

LIGJI Nr. 05/L-057
PËR THEMELIMIN
E FONDIT
KOSOVAR PËR
GARANCI
KREDITORE
LIGJI Nr. 05/L-057
PËR THEMELIMIN
E FONDIT
KOSOVAR PËR
GARANCI
KREDITORE

Nenet

Neni 1

1. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore krijohet për të ndihmuar në përmbushjen e nevojës për rritje të qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor dhe shërbimet me vlerë të shtuar, përmirësimit të bilancit tregtar dhe për të zgjeruar mundësitë e financimit për NMVMtë. 2. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ofron garanci kreditore për Institucionet e Regjistruara Financiare për kredi të caktuara të NMVM-ve. FKGK do të mund të ofrojë shërbime të tjera financiare me aprovimin paraprak të Bordit të Drejtorëve dhe BQK-së.